



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Komuna e Vushtrrisë
Opshtina Vushtrri/Municipality of Vushtrri



PLANI I VEPRIMIT PER PERSONAT E RIATDHESUAR NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

HYRJE

Duke u bazuar në planin e veprimit të dalur nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Strategjia për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, edhe Komuna e Vushtrrisë ka hartuar planin e veprimit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

Numri I personave të cilët e kanë lëshuar Kosovën e përkatësisht Komunën e Vushtrrisë si para, gjatë dhe pas luftës ka qenë I konsiderueshëm dhe si rrjedhojë e kësaj çështje edhe numri I personave të riatdhesuar ka qenë I konsiderueshëm.

Pas riatdhesimit të gjithë e dimë se dera e Komunës është një ndër dyert e para ku drejtohen qytetarët e në këtë rastë personat që depërtohen nga vendet e ndryshme të Europës qëft individ apo familje të cilat kthehen me dhunë ose vullnetarisht. Për këtë arsye Komuna ka formuar një komision që të hartoj planin e veprimit dhe personave që kthehen nga perendimi tu dal në ndihmë sa më mirë që është e mundur. Edhe pse me buxhetin të cilin e ka ndarë Qeveria e Republikës së Kosovës Komunat nuk kanë qasje në të prap se prapë ne po mundohemi që qytetarëve tona tu krijojmë kushte dhe hapsirë të mjaftueshme që me të vërtetë ata të ndihen me të vërtetë se Kosova është shtëpia e tyre.

Komuna së bashku me zyrtarët nga MPB u mundëson atyre personave që të zgjedhin qështjen e banimit atyre personave që me të vërtetë e kanë problem qështjen e strehimit.

Komuna ka për qëllim lehtësimin nga pagesa në periudhën 6-12 muaj shërbime të ndryshme..

Për të qenë sa më afër këtyre personave Komuna organizon vizita në terren ku këta persona vizitohen nga zyrtarët komunal që të njoftohen më përsëafërmi lidhur me gjendjen e këtyre personave. Gjithashtu këtyre personave do tu ofron edhe broshura lidhur me kriterët dhe kushtet e ri-integrimit për personat e riatdhesuar.

OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	INSTITUCINET BASHKËPUNUESE
<p>1. Zbatimi I kornizës ligjore në fushën e migracionit, re-integrimit dhe riatdhesimit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare</p>	<p>1.1 Rishikimi I vazhdueshëm i legjislacionit relevant, në përputhje me zhvillimet e të drejtës ndërkombëtare.</p> <p>1.2 Përcaktimi I përgjegjësive dhe funksioneve, të anëtarëve të komisionit komunal, në kuadër të kompetencave</p>	<p>Komisioni për Hartimin e Planit të Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.</p>	<p>Ministria për Integrim Evropian</p> <p>Ministria e Administratës Publike.</p> <p>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</p> <p>Ministria e Arsimit</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>
<p>2. Ofrimi I shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e re-integrimit të personave të riatdhesuar.</p>	<p>2.1 Pasqyrimi i informacioneve për mbështetjen e riintegrimin në faqen zyrtare të internetit për përfitime të të kthyerve dhe zyrtarëve që merren me procesin e riatdhesimit dhe re-integrimit, duke përfshirë organizatat e interesuara relevante.</p> <p>2.2 Pasqyrimi i informacioneve për mbështetjen e riintegrimin në faqen zyrtare të internetit për përfitime të të kthyerve dhe zyrtarëve që merren me procesin e riatdhesimit dhe re-integrimit,</p>	<p>Drejtoria për Administratë të Përgjithshme</p> <p>Drejtoria për Shëndetësi</p> <p>Drejtoria për Arsim</p> <p>Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	

	<p>duke përfshirë organizatat e interesuara relevante.</p> <p>2.3 Re-integrimi ligjor nëpërmjet pajisjes së personave të riatdhesuar me dokumente personale.</p> <p>2.4 Lehtësimi I qasjes në shërbimet e përkujdesjes shëndetësore.</p> <p>2.5 Lehtësimi I qasjes në sistemin publik të arsimimit në të gjitha nivelet.</p> <p>2.6 Ofrimi I kurseve për fëmijët të cilët nuk flasin gjuhën e tyre amtare.</p> <p>2.7 Ofrimi I transportit për nxënësit e nivelit të parë dhe të dytë në zonat ku është i rregulluar transporti.</p> <p>2.8 Ofrimi I dokumentacionit të nevojshëm për shkollimin e përfunduar.</p> <p>2.9 Organizimi I kurseve profesionale varësisht nga kërkesat dhe nevojat e personave të riatdhesuar.</p>	<p>Komisioni për Hartimin e Planit të Veprimit për Re-integrimin e Personave të Riatdhesuar.</p>	
--	---	--	--

	<p>2.10 Punësimi I personave të riatdhesuar permes programeve dhe projekteve të veçanta.</p>		
<p>3. Zbatimi I prioriteteve të fondit në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>3.1 Vlerësimi I nevojave të personave të riatdhesuar dhe paraqitja e kërkesës në përputhshmëri me kriteret për shfrytëzimin e fondit.</p>		
<p>4. Raportimi dhe vlerësimi I zbatimit të strategjisë permes koordinimit dhe kontrollit të aktiviteteve</p>	<p>4.1 Raportimet e rregullta mujore tek Kryetari I Komunës.</p> <p>4.2 Identifikimi dhe eliminimi I pengesave në zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar</p> <p>4.3 Organizimi I takimeve.</p> <p>4.4 Vizita e personave të riatdhesuar nga Kryetari I Komunës dhe zyrtarëve komunal.</p>		